

PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE NË MJEDIS LIDHUR ME TEC-IN E VLORËS

Prezantimi

Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) I është kërkuar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) për të marrë pjesë në financimin e ndërtimit të Impiantit Gjenerues me Cikël të Kombinuar në Vlorë. Stacioni energjetik parashikohet të ketë një ngarkesë bazë me kapacitet 85-135 MVA. Ku lënda djegëse e distiluar do të konvertohet në gaz natyral. Si ndërtimi ashtu edhe vënia në funksionim mund të shkaktojnë ndikime në mjedis dhe ka dalë e nevojshme një vlerësim për ndikimet në mjedis.

Kjo përmbledhje e VNM-së është përgatitur për prezantimin e propozimeve të BERZH-it lidhur me pjesëmarrjen e bankës në këtë projekt. Është e bazuar në VNM dhe duke përdorur materiale të përgatitura nga Banka Botërore për prezantimin dhe diskutimin me publikun.

1. Vendet e përzgjedhura dhe Alternativat

Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin (USTDA) I ka dhënë një grant Qeverisë Shqiptare për të asistuar në zhvillimin e TEC-it të ri. Ministria e Industrisë dhe Energjetikës shqiptare duke pasur parasysh dhe konsultimet me (Montgomery Eaton Harza; MËH) ka nxjerrë tre detyra:

Detyra e parë ka qenë vlerësimi dhe përzgjedhja e lokaliteteve më të mira, lëndën djegëse për ngarkesën baze të impiantit gjenerues termal.

Detyra e dytë ka qenë kryerja e një studimi për fizibilitetin dhe vlerësimin e kërkesave teknike si mjedisore, ekonomike dhe financiare të impiantit gjenerues në lokalitetin e përzgjedhur.

Detyra e tretë ka qenë kryerja e një VNM të impiantit të propozuar.

Në detyrën e parë, MËH ka vlerësuar shtatë lokalitete të mundshme duke përfshirë dhe lokalitete në afërsi të Durrësit, Elbasanit, Korcës, Fierit, Shëngjinit dhe dy lokalitete në afërsi të Vlorës- Zona Vlorë A dhe B. Lokalitetet u vlerësuan duke përdorur një metodologji automatike, e cila i ka përzgjedhur në bazë të numrit të kriterëve si furnizimi me lëndë djegëse, ujë, mundësi transmetimi, kosto dhe duke marrë në konsideratë mjedisin si edhe të tjera. Në 6 qershor 2002 ka dalë një Draft i detyrës së parë sipas së cilit ka cilësuar Zonën Vlorë B si lokalitetin më të mirë dhe lëndën djegëse të distiluar si më të përshtatshmen për ngarkesën baze të gjenerimit me cikël të kombinuar si teknologjinë e gjenerimit më të mirë.

Duke u bazuar në lokalitetin, teknologjinë dhe lëndën djegëse të përzgjedhur në Detyrën e parë, MËH ka kryer një studim të detajuar fizibiliteti në detyrën e dytë për të vlerësuar kërkesat teknike si ato mjedisore, financiare dhe sociale në zhvillimin e impiantit në lokalitetin e përzgjedhur. Studimi I fizibilitetit është fokusuar në zhvillimin e impiantit me një kapacitet 90-130 MVA. Studimi rikonfirmoi rekomandimet e marra nga studimi i lokalitetit.

Detyra e tretë për Vlerësimin e ndikimeve në mjedis në lokalitetin e Vlorës është në përputhje me kërkesat e tre institucioneve financuese potenciale (Banka Botërore, BERZH, EIB). Vlerësimi I ndikimeve në mjedis dhe plani për mbrojtjen e mjedisit janë përgatitur nga Montgomery Group financuar nga USTDA. Ka dalë dhe rishikimi I pavarur I EA dhe EMP nga Këshilltarët të financuar nga CIDA.

2. Lokaliteti

Lokaliteti I përzgjedhur në Vlorë është një fushë prej gjashtë hektarësh praën platformës naftëmbajtëse në bregun verior të Adriatikut. Është e vendosur përafërsisht gjashtë km nga Porti I Vlorës. Lokaliteti ndodhet në zonën bregdetare me nje vegjetacion të vogël.

Në zonën e Vlorës nuk ka burime të emetimeve të ajrit. Shumica e industrive së impanteve që funksiononin në Vlorë janë mbyllur në vitin 1990. në sajë të mungesës së aktivitetit industrial në zonë dhe mungesës të të dhënave të besueshme, është presupozuar që kushtet e ajrit në zonën e Vlorës janë në përputhje me kriterin e Bankës Botërore.

Nuk ka pasur shpronësime apo blerje të terrenit për stacionin energjetik sepse ky terren është në pronësi të Qeverisë. Rreth 0.8 hektar të terrenit nevojitet të blihet për ndërtimin e kullave të transmetimit për 7 km ose dyfish të qarkut 220 kV të linjës së transmetimit që nevojitet për lidhjen e stacionit me nënstacionin e Babicës. Blerja e terrenit nuk përfshin.

3. Konsultimi me publikun

Publiku është angazhuar me anë të diskutimeve lidhur me projektin në vlerësimin e ndikimeve në mjedis. Lajmërimet(njoftimet) publike janë shpërndarë në tërësi dhe kanë qenë transparente. Në përputhje me me Planin e Prezantimit dhe Diskutimit me publikun, ftesat për marrjen pjesë në takime I janë dërguar institucioneve dhe individëve. Agjencia Kombëtare Energjetike (AKE) ka bashkërenditur këtë process me Ministrinë e Industrisë dhe Energjetikës, KESH-in, Ministrinë e Mjedisit, me PNUD-in në projektin e Lagunës së Nartës, Bashkinë e Vlorës, Rajonin e Vlorës, Prefekturën e Vlorës, qytetarë të Vlorës, studentët e Universitetit të Vlorës, stacionet televizive locale dhe kombëtare, dhe me më shumë se 20 organizata joqeveritare si dhe me organizata të tjera sociale dhe ambientale.

Takimet diskutuese me publikun janë mbajtur në Vlorë. Takimi I parë është mbajtur në Vlorë në vjeshtë të 2002 për të paraqitur projektin publikut dhe për të filluar procesin e diskutimit me publikun. Takimi I dytë është mbajtur në Vlorë në 2 prill 2003 për të marrë sugjerimet e publikut për studimin e vlerësimit të ndikimeve në mjedis. Mbi 100 persona kanë qenë në takimin e dytë, duke përfaqësuar agjensi të ndryshme qeveritare, universitete, organizata joqeveritare dhe publik. Takimet janë regjistruar nga stacionet televizive shqiptare dhe janë dhënë në edicionet e lajmeve të natës.

Takimi tretë është mbajtur në 3 shtator 2003 në Vlorë për të diskutuar draftin e VNM. Është ndjekur nga 35 persona duke përfaqësuar agjensi lokale dhe kombëtare qeveritare, agjensi jo qeveritare dhe publik. Detajet kryesore të projektit dhe të VNM janë prezantuar

publikut 30 ditë përpara takimit. Kopjet e draftit të VNM janë shpërndarë në Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Rregullim territorit dhe Turizmit, Ministrinë e Industrisë dhe Energjetike, KESH, AKE, librarive në Vlorë, Rajonit të Vlorës dhe prefekturës së Vlorës. Kopje të draftit të VNM dhe kopjet në shqip janë dërguar Bashkisë së Vlorës, Rajonit të Vlorës dhe Prefekturës së Vlorës. Njoftimi I është dhënë dhe tre gazetave kryesore shqiptare për të informuar të gjithë të interesuarit për gjendshmërinë e draftit të VNM për rishikim dhe për sugjerime.

Në tërësi procesi I prezantimit me publikun, takimet janë ndjekur nga grupe të ndryshëm të interesuarish, dhe publiku ka dhënë sugjerimet dhe shqetësimet e tyre. Publiku ka qenë në gjendje të parashikojë shqetësimet në lidhje me efektet specifike të stacionit të propozuar. Sugjerimet janë marrë në konsideratë në procesin e VNM-së.

Në tetor të 2003, Banka Botërore prezantoi Raportit përfundimtar të VNM-së dhe përmbledhja e VNM-së mund të gjendet në faqen e internetit www.worldbank.org.

4. Ndikimet në mjedis

Ndikimet e mundshme në ambjent janë identifikuar në VNM dhe janë pershkruar më poshtë. Gjithashtu kjo përfshin identifikimin e marrjes së masave lehtësuese të cilat janë përfshirë në Planin e mbrojtjes së mjedisit, të paraqitur në seksionin 5. masat lehtësuese janë të rradhitura si më poshtë.

4.1. Ndikime gjatë fazës së ndërtimit

Emetime të ajrit. Pluhurat mund të emetohen nga lokaliteti I punës, rregullimet e rrugës (hyrjet e rrugëve do të kërkojnë nivelin dhe rishtrim), trafiku (lidhur me dërgimet e materialeve dhe pajisjeve). Gjithashtu funksionimi I makinerive me fuqi diesel dhe automjeteve mund të kenë ndikime në cilësinë e ajrit

Emetimet e pluhurave nga rrugët dhe lokalitetit të punës mund të eliminohen ose të minimizohen nga aplikimi I ujit në rrugë dhe në zonat ndërtuese të ekspozuara gjatë sezonit të nxehtë. Pikat e emetimeve nga stacione konkrete mund të kontrollohen me pajisje të përshtatshme si filtrate e fabrikave ose të ciklimeve të vecanta. Pajisjet ndërtuese me fuqi diesel dhe automjetet mund të arrijnë të minimizojnë emetimet e tubave.

Modeli I shpërhapjes së ajrit ka treguar që pluhurat e mundshëm të shkaktuara nga ndërtime dhe automjete në rrugë mund të përmbushin standartet e cilësisë së ajrit të Bankës Botërore dhe të Komunitetit European.

Zhurma. Zhurma e shkaktuar nga ndërtimi mund të jetë e rëndësishme. Zhurma e emetuar nga pajisjet duhet të përmbushi standartet që KE aplikon dhe duhet të jetë nënkontroll.

Uji nëntokësor dhe sipërfaqësor

Duhet të shtrohet për diskutim uji nëntokësor në afërsi të lokalitetit gjatë gërmimit në themel për heqjen e ujit. Megjithatë, burimet nënujore në këtë zonë janë të kufizuara dhe uji nëntokësor nuk është I përdorshëm për përdorim shtëpiak ose për qëllime të tjera. Në fakt nuk pritët që tharja e ujit të shkaktojë ndikime të rëndësishme. Shkarkimet e ujit mund të kontrollohen që të minimizojnë ndikimin e cilësisë së ujit në afërsi të sipërfaqes

së burimeve ujore sic është Narta, Gjiri I Vlorës. Mund të përdoren masa kontrolluese për sedimentet, për të minimizuar transportin e sedimenteve jashtë lokalitetit. Masa si rrethime për ndotjet mund të implementohen për të minimizuar erozionin dhe grumbullimet.

Uji I nxjerrë nga heqja e ujit mund të përmbajë lëndë solide, naftë dhe graso. Duhet të merren masa për të lëvizur këto lëndë solide përpara heqjes së ujit nga lokaliteti, duke përfshirë dhe struktura për heqjen e këtyre. Ndërsa nfatën ose grason mund të thithen në sipërfaqe duke përdorur pajisje absorbuese.

Rrjedhje aksidentale të lëndëve djegëse mund të kontaminojnë bregdetin ose ujin. Punëtorët do të trajnohen për ruajtjen, mbajtjen dhe shkarkimin e këtyre lëndëve ose të materialeve toksike. Duhet të përgatitet një plan emergjence për lokalitetin dhe punëtorët duhet të trajnohen që të ndjekin procedurat specifike në rast rrjedhjeje. Masat lehtësuese përfshijnë:

- Mbylljen e të gjithave lëndëve dhe lubrifikantëve nga pajisja ndërtuese dhe shkarkimin e tyre në mënyrë të përshtatshme
- Ndërtimin e kontenjerëve dhe pajisje të tjera
- Inspektimin rregullisht të zonave të kontenjerëve dhe të pajisjeve; dhe
- Ndërtimin dhe mbajtjen e impiantëve për të hequr ujin e shiut strukturat e kontenjerëve dhe heqjen e naftës nga sipërfaqja e materialit të grumbulluar.

Burmiet agregate

Meqënëse më afërsi të lokalitetit ekzistojnë gurore duhet të parashikohen burime të mjaftueshme për kërkesat e ndërtimit. Megjithatë, kur kërkesat për agregatet aktuale do të bëhen të njohura, investigime të tjera duhet të ndërmerren. Burimet jashtë lokalitet duhet të identifikohen dhe miratimet e përshtatshme duhet të merren para marrjes së lokalitetit. Këto lokalitete duhet të shikohen sipas përdorimit.

Habitati detar.

Instalimi I tubacioneve të marrjes dhe shkarkimit të ujit të ftohtë mund të ndikojë në habitatin detar. Puna mund të përfshijë shkarkimet e materialeve të gërmimeve, të cilat mund të shkaktojnë sedimente në rrethinat e mjedisit detar. Cdo shkarkim detar duhet të kryhet larg zonave të peshkimit ose nuk duhet të kryhet në kohën e baticës. Aktivitetet e ndërtimit të tubacioneve për marrjen dhe shkarkimin e ujit të ftohtë nuk duhet të kryhen gjatë sezonit të peshkimit

Lundrimi bregdetar.

Aktivitetet e ndërtimit nuk ndërhyjnë në lundrimin bregdetar të anijeve për pasagjer. Të gjitha maunet, bovat, pajisjet lidhur me projektin e ndërtimit duhet të garantohen nga ndricimi natën.

Transporti .

Duke pasur parasysh rrugët ekzistuese në zonën e Vlorës, është e rëndësishme që këto rrugë të nivelohen dhe të shtrohen për të pasur një trafik të zakonshëm. Duke skeduar dërgesat e përbërësve kryesorë të stacionit në një orar të përshtatshëm për trafikun mund të ndihmojë që most ë ketë ndikime në fluksin local të trafikut. .

4.2. Ndikime gjatë fazës funksionuese

Emetimet e ajrit.

Kombustimet e naftës së distiluar gjatë funksionimit të stacionit mund të shkaktojnë emetime të sulphur dioxide, nitrogen oxides, carbon monoxide, carbon dioxide, grmica materiesh në më pak se 10 mikron. Grimcat mund të përmbajnë një sasi metalesh. Impanti I gjenerimit do të projektohet që të jetë sa më afër limiteve të ndikimeve në cilësinë e ajrit sipas standarteve të KE dhe Bankës Botërore. Emetimi I sulphur dioxide duhet të kontrollohet nga kufizimi I sulfurit që përmban lënda djegëse.

Emetimi I Nitrogen oxide duhet të kontrollohet nga djegja dhe nga injektimet e ujit në turbine me djegje të brendshme. Emetimet e grimcave duhet të ulen nga kontrolli I djegjes së brendshme të mirë për të minimizuar produktet e djegjes së paplotë.

Agjensia e SHteteve të Bashkuara për Mbrojtjen e mjedisit së burimeve industriale (ISC3) ka vlerësuar ndikimin e funksionimit të stacionit për cilësinë e ajrit. Rezultatet përputhen me standartet e KE dhe Bankës Botërore për carbon monoxide, nitrogen oxides, and sulphur dioxide. Duke përdorur të dhënat kryesore marrë nga Agjensia Rajonale Mjedisore e Vlorës, është përcaktuar që emetimet e shkaktuara nga TEC-I I Vlorës për cilësinë e ajrit mbeten po në kategorinë e moderuar. Ky rezultat përputhet me kërkesat e Bankës Botërore, BERZH-it, EIB për stacionet gjeneruese

Zhurma.

Funksionimi I turbinave mund të shkaktojë zhurma, gjithashtu edhe gjeneratorët. Turbinate me djegje të brendshme duhet të projektohet për të kufizuar zhurmën në 85 decibels (A) sipas kërkesave të KE dhe Bankës

Rrjedhja e lëndës djegëse

Gjatë lundrimit, ngarkimit, transferimit të lëndës djegëse në magazinat e lokalitetit mund të shkaktohen rrjedhje. duhet të përdoret një bovë për të mbajtur rrjedhjet gjatë lundrimit, ngarkimi dhe mbylljes së procedurës. Duhet të kryhen inspektime frekeunte për mirëmbajtjen e impianteve në mënyrë që të minimizohen rrjedhjet nga transferimi në tubacione deri në maune.

Marrja e ujit

Sistemi I marrjes së ujit kryhet në zonën e lokalizuar të ekosistemit detar ku është është instaluar një strukturë marrëse. Do të merren masa për shqetësimet e para për mbrojtjen e specieve detare që mund të shkaktojë marrja e ujit. Parametra të duhura mund të përdoren për të minimizuar ndikimin tek peshqit. Gjithashtu do të merrren masa mbrojtëse për të parandaluar hyrjen e peshqve në system

Rrjedhjet termale.

Se pari nepermjet centralit me uje te paster qe rrjedh nga Gjiri I Vlores duhet te rritej temperatura ne afersi te pjeses ku do rrjedhi. Impakti termal I modeluar eshte vleresuar dhe perdorur nga (CORMIX). Eshte percaktuar qe rritja e potencialit te temperatures se ujit duhet te jete me pak se standartet e Bankes Boterore dmth nene 3 grade celcius. Nese impaktet jane me te medhaja se ato te dhena pas fillimit te operacionit, modifikimet ne shkarkues duhet te rrisin rrjedhjen ne instrumentin mates

Shkarkime kimike në ujin e ftohtë

Shkarkimet e ujit të ftohtë në stacion mund të jetë I neglignueshëm

Shkarkimi I ndotjeve të ujit

Shkarkimi I ndotjeve të ujit do të projektohet që të jetë në përputhje me standartet e Bankës Botërore

Mbeturina të rrezikshme

Sasia e mbeturinave të rrezikshme të krijuara do të jetë shumë e ulët dhe nxjerrë nga mbajtjet e burimeve. The amount of hazardous waste created could be very low and originate from maintenance sources. Mbeturinat përbëhen nga mbeturiant e lubrifikantëve dhe solventëve. Nuk ka mbetje nga kombustimi I lëndës djegëse të distiluar apo nga akumulimi I lëndës djegëse në magazine

Afërsia e Lagunës së Nartës

Lokaliteti është vendosur 2 km në jug të Lagunës të Nartës. Laguna dhe ekosistemi rrethues shtrihen nga veriu i deltës së Lumit të Vjosës dhe ka përafërsisht 10.000 hektar, është e përbërë nga pyje, kënetam duna ranore, plazhe dhe vende agrikultuese dhe në të jetojnë specie jo të rrezikshme. Parlamenti është duke pritur që ta projektojë Lagunën e Nartës si Zonë e Mbrojtur sipas ligjit të ri i cili parashikon për stabilizimin e zonave të mbrojtura dhe për të garantuar mbrojtjen e burimeve natyrale, mbron biodiversitetin dhe restauron dhe mirëmban habitatin dhe speciet.

Qeveria ka konfirmuar që TEC- I Vlorë të jetë jashë kufirit të zonës së mbrojtur të Lagunës së Nartës. Në Lagunën e Nartën nuk do të ketë ndikime nga shkarkimet termale ose shkarkimet e ujërave të ndotur nga stacioni. Stacioni përputhet me gjithë standartet e cilësisë së ajrit, duke përfshirë dhe për mbrojtjen e vegjetacionit dhe ekosistemit.

5. Plani I mbrojtjes së mjedisit

Për këtë projekt është zhvilluar një plan për mbrojtjen e mjedisit dhe do të implementohet nga KESH-i. Plani I mbrojtjes së mjedisit përcakton masat e nevojshme për të parandaluar, minimizuar, lehtësuar ose kompensuar ndikimet që mund të shkaktohen dhe garanton përputhje me politikat e mbrojtjes të aplikuara, këto janë të përfshira në projekt. Rekomadimet për qëllimet e masave lehtësuese për mjedisin janë si vijon:

5.1. EMP: Faza e ndërtimit

- Megjithëse pemët mund të ndikojnë në vendin e punës, asnjë pemë nuk do të pritët
- Ndersa pamja e disa pemëve do te mund te ndikohet nga vendpunimi, asnjë pemë qe nuk nderhyn ne vendpunim nuk do të pritët, dhe drutë e prerë do te vihen në dispozicion te banoreve.
- Lokaliteti përfundimtar do te lehtësohet nga drenimi, do te parandaloje përmytjet , depozitimn e ujrave. Një plan për një vend drenimi do te bëhet për ta mbrojtur kundëer erozionit. Gjatë ndrtimit do të minimizohet erozioni me anë të stivave me thasë, rrethimeve, dhe minimizimit te këndeve te pjertësisë së tokës.
- Pajisja ndërtuese do të përputhet me standartet e aplikuara nga direktiva te 14 majit 2002 të KE. Puna me zhurmë të bezdisshme do te minimizohet gjatw netëve dhe ditëve të pushimit.
- Për të ulur pluhurin nga nivelimi I rrugëve, zonat e punuara do te ujiten sipas domosdoshmërisë.

- Në vendet që kërkohet tharje, uji do të inspektohet vizualisht për kontaminim me lëndë djegëse përpara shkarkimit në vendin e drenazhit. Uji i kontaminuar me lëndë djegëse do të trajtohet përpara se të hidhet.
- Terrenet e marra hua do të shmangin zonat bujqësore; terrenat e marra hua do të ripunohen që t'i përshtaten zonave përreth. Re-vegjetacioni do të zhvillohet duke përdorur plantacioneve locale. Të gjitha pjertësitë dhe sipërfaqet e punimeve do të rikthehen në kushtet normale.
- Furnizimi me ujë që do të përdoret për ndërtimin e TEC-it, do të monitorohet për të garantuar që nuk do të ndikojë për keq për përdorimet të tjera të ujit në zonë.
- Magazinat e lëndës djegëse, contenier dytesore me volum të mjaftueshëm që të përmbajnë rrjedhjet nga contenierët e mëdhenj në strukturat e tyre. Zonat e contenierëve do të kenë mundësinë për të lëvizur ujin e akumuluar. The containment area should have a means of removing accumulated water. Kanalizimet e ujit do të jenë vecas me anë të ndarsëve të ujit.
- Përpara fillimit të ndërtimit do të krijohet një plan emergjence për rrjedhjet .
- Do të përdoren burimet e agregatëve ekzistues, dhe nuk do të zhvillohen burime të reja.
- Ujrat e përmbajtjeve do të shkojnë direkt në sistemin e drenazhit.
- Fluksi hyrës i punonjësve nuk do të tejkalojë 350 deri më 500 individë. Punëtorët do të strehohen në Vlorë dhe do të shkojnë në punë me autobus. Ndihma e shpëjtë do të jepet në vend.
- Nivelimi i hyrjes kryesore të rrugës në stacion do të ketë një efekt pozitiv në trafikun lokal. Pluhri i rrugës do të minimizohet gjatë ndërtimit me anë të ujit dhe rrugës së asfaltuar. Kamjonat do të mbulohen kur të jenë të ngarkuar. Shpejtësia e rrugës do të kontrollohet për të ulur aksidentet e mundshme.
- Mbeturinat solide do të jepen për përdorim të përshtatshëm kontraktorëve lokalë.
- Në impjant do të parashikohet një kanalizim për ujrat e zeza. Nuk do të ketë shkarkim të ujrave të zeza të pa trajtuara më parë.
- Shqetësimi i jetës nënujore do të minimizohet nga studimet e kryera për marrjen dhe shkarkimin e ujit.
- Mbeturinat e ndertimeve nuk do të hidhen në gjë. Marrja dhe shkarkimi i ujit do të kryhet në mënyrë që të minimizojë hedhjen e sedimenteve në gjë. Periudha e për kryerjen e marrjes dhe sharimit do të skedulohet për të minimizuar ndikimin tek peshkatarët. Të gjitha maunet dhe bovat do të ndricohen gjatë natës.
- Dheu sipërfaqësorë do të përpunohet që të jetë e përshtatshme.

5.2 EMP: Faza Funksionuse

- Turbinat me djegje të brendshme do të punojnë me një teknologji të lartë nga lëndët e dëmshme. Nitrogen oxides do të kontrollohet duke përdorur ujin e injektuar. Sulphur dioxide do të kontrollohet kryesisht nga djegja e sulfurit me përqindje të ulët, të lëndës djegëse të distiluar. Duke përdorur një djegje të brendshme të kontrolluar mund të kontrollohet carbon monoxide, grimcat e materjeve dhe lende organike të gazta.
- Turbinat me djegje të brandshme do të kenë një mbyllje të brendshme për të garantuar që zhurma të mos kalojë 85 dB(A) në 1 m. Punonjësit në afërsi të kësaj pajisje do t'i kërkojnë që të përdorin veshje mbrojtëse. Zhurmat jashtë lokalitetit nuk do t'i kalojnë 70dB(A) në 1 m. Në afërsi të zonës së lokalitetit nuk ka shtëpi banuese.

- Vendi për marrjen e ujit të ftohtë do të zgjidhet për të minimizuar ndikimin në mjedisin ujor. Për marrjen e ujit do të përdoren masat mbrojtëse. Do të përdoren pompa thithëse për transportin e marrjes së ujit. Shpejtësia e marrjes së ujit nuk do të kalojë 1 m/s, që të minimizohet blokimi i kanelave nga mbeturiat.
- Stacioni do të furnizohet me uje të embel të filtruar të marrë nga deti Adriatik.
- Kanalizime për mbeturina do të përdoret për hedhjet e ndryshme të cilat do të kombinohen me shkarkimet e ujit të ftohtë.
- Shumica e punonjëseve do të jenë nga zona e Vlorës. Megjithatë infrastruktura e qytetit të Vlorës, mund të strehojë punonjësit e ardhur dhe nga rrajone të tjera.
- Do të ketë një plan për rrdhjet dhe për pajisjet të cilat mbajnë lëndë djegse dhe materiale të rrezikshme.
- Magazina e lëndës djegse do të përfshijë një kontanier të dytë me përmasë të mjaftueshme që të mbajë 110% të përmbajtjes së kontanierit më të madh. Do të përfshihet dhe një mënyrë për të hequr ujin e shiut. A means of removing rainwater could be included. Kanalizimet e ujit do të jene vecas me anë të ndarsëve të ujit.
- Linjat e transmetimit mund të pastrohen dhe mund t'i minimizojnë ndikimet në zonat e banuara. Fusha elektro-magntike e emetuar nga keto linja do të kontrollohen.
- Vepra do të mbulohet me peme dhe do të vendoset me kurriz nga deti. Pamja do të përdoret për të rritur appearancen e vepres

5.3 Monitorimi

Nje plan monitories I detajuar per ambjentin eshte bere per te verifikuar qe parashikimet e impakteve te mjedisit jane te sakta dhe se impaktet e parashikuara jane zbuluar ne nje faze te heret dhe qe lejojne masa korrektuese per tu implementuar, nese kerkohen

- Gjate fazes ndertuese plani siguron monitorim per pluhurin,,zhurmat,dhe per derdhjen e ujit
- Gjate periudhes operuese, monitorimi eshte planifikuar per emetimin e ajrit dhe per cilesine ajrit, per zhurmat,per derdhjen e ujit dhe per mjedisin biologjik detar si dhe nje inspektim te tubave te ajrosjes, magazinimin dhe per rajonin e dhene.
- Nje konsulence per monitorim specifik te ambjenit eshte planifikuar per projektin per tu siguruar se monitorimi do te kryhet ne perputhje me planin

6. Procedurat per hapjen dhe konsultimet

Ne kuadrin e pjesemarrjes se EBRD ne project materialet e MIE do te jene te disponueshme ne perputhje me hapjen publike te procedurave konsultuese, per nje rishikim prej 120 ditesh dhe per komente per periudhen nga 9 Shkurt deri ne 7 qershor 2004 ne vendet e meposhtme

- Zyres se KESH ne Vlore
- zyren e mardhenieve publike ne Kesh
- Zyres se BERZH ne Tirane
- Business Information Centre, EBRD, London, UK, tel +44 171 338 6747